

20100520943

L I G J **PËR SHOQATA DHE FONDACIONE**

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Lënda e ligjit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen mënyra, kushtet dhe procedura për themelim, regjistrim dhe shuarje të shoqatave, fondacioneve, lidhjeve, formave organizative të organizatave të huaja në Republikën e Maqedonisë, prona të cilën e disponojnë, mbikëqyrja, ndryshimet statusore dhe statusi i organizatave me interes publik.

Neni 2

Dispozitat e këtij ligji nuk kanë të bëjnë me partitë politike, kishat, bashkësitë fetare dhe grupet religjioze, sindikatat, odat dhe llojet e tjera të bashkimit të rregulluara me ligje të veçanta.

2. Kuptimi i shprehjeve të përdorura në këtë ligj

Neni 3

Shprehjet e veçanta të përdorura në këtë ligj, e kanë kuptimin si vijojnë:

1. "Organizatë" është çdo shoqatë, fondacion, lidhje si dhe secila formë organizative e organizatës së huaj, si dhe forma tjetër e organizimit, të regjistruara në pajtim me dispozitat e këtij ligji;
2. "Veprimtari" është aktiviteti i klasifikuar sipas klasifikimit nacional të veprimtarive me të cilën organizatat i realizojnë qëllimet e tyre të përcaktuara me statut;
3. "Akt për themelim" është akti me të cilin themelohet organizata;
4. "Pronë" e organizatës janë të gjitha të drejtat pronësore dhe të drejta të tjera reale të cilat organizata i fiton mbi mjetet e tundshme dhe të patundshme dhe të drejtat të cilat themeluesit i kanë investuar në organizatë dhe të cilat organizata i ka fituar me punën e saj;
5. "Statut" është akti me të cilin rregullohet veprimtaria, organizimi dhe funksionimi i organizatës;
6. "Ndryshimet statusore" e paraqesin bashkimin, bashkëngjitjen dhe ndarjen e organizatës në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara me këtë ligj;
7. "Akte tjera" janë aktet me të cilat rregullohen marrëdhëniet të cilat nuk janë të rregulluara me aktin për themelim ose me statut (rregullorja, vendimi, rregullorja e punës, programi dhe akte të tjera);
8. "Organ për mbikëqyrje" është organi (këshilli mbikëqyrës, komisioni për revizion ose kontrollori), punët e të cilit janë të lidhura me mbikëqyrjen mbi punën e organizatës;
9. "Masë e pronës" janë paratë, mjetet dhe/ose të drejtat të cilat themeluesi i lëshon dhe ia bart fondacionit në procedurën e themelimit;
10. "Përfaqësues" është personi ose organi në organizatë (përfaqësuesi i shoqatës, drejtori i fondacionit, ose organi i përcaktuar me statut) të drejtat, autorizimet dhe përgjegjësitë e të cilit janë të lidhura me udhëheqjen e organizatës dhe përfaqësimin e organizatës në pajtim me ligjin;
11. "Vendimmarrje pa prani" është mënyra nëpërmjet së cilës anëtarët e organeve deklarohen, pa mbajtur mbledhje të organit ose pa praninë e anëtarit të organit, e nëpërmjet të konferencës telefonike, nënshkrimit të aktit ose në mënyrë tjetër të rregulluar me statutin e organizatës;
12. "Deklaratë/pajtim i verifikuar" është akti nënshkrimi i të cilit është verifikuar te noteri;
13. "Person" është çdo personi fizik dhe juridik, përveç nëse nuk është theksuar se është person fizik, ose se është person juridik;

14. "Organizatë e huaj" sipas këtij ligji është shoqata e huaj ose ndërkombëtare, fondacioni ose forma tjetër e organizatës e themeluar për realizimin e qëllimit të përbashkët, i cili nuk është për përfitim dhe është themeluar në pajtim me sistemin juridik të shtetit të huaj;

15. "Person i huaj fizik" është personi i cili ka vendbanim ose vendqëndrim në Republikën e Maqedonisë;

16. "Organizatë me status me interes publik" është organizata e cila e ka fituar statusin e organizatës me interes publik në pajtim me këtë ligj;

17. "Konflikt i interesave" e nënkupton konfliktin e autorizimeve dhe obligimeve në lidhje me punën e organizatës, me interesin privat të personit i cili ka autorizime dhe detyra, në të cilat interesi privat ndikon ose mund të ndikojë mbi kryerjen e autorizimeve dhe detyrave në lidhje me punën e organizatës dhe

18) "Qëllim" i organizatës është rezultati i projektuar ose gjendja të cilën organizata duhet ta arrijë.

3. E drejta e bashkimit

Neni 4

(1) E drejta e bashkimit të lirë realizohet nëpërmjet bashkimit në shoqata, fondacione, lidhje dhe forma organizative të organizatave të huaja (në tekstin e mëtejshëm: organizata) për realizimin e qëllimeve, veprimtarive të tyre dhe mbrojtjen e të drejtave, interesave dhe bindjeve në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin.

(2) Ndalohet themelimi i organizatës nëse programi dhe veprimi i saj është përcaktuar për shkatërrimin e dhunshëm të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë, nxitje dhe thirrje në agresion ushtarak dhe nxitje të urrejtjes nacionale, racore ose fetare ose mosdurimit, ndërmerr aktivitete të lidhura me terrorizmin, ndërmerr aktivitete të cilat janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin dhe cenohen liritë dhe të drejtat e personave tjerë.

4. Bashkimi i organizatave

Neni 5

(1) Dy ose më shumë organizata mund të bashkohen në lidhje ose formë tjetër të organizimit, e cila mund ta marrë cilësinë e personit juridik, me regjistrim në pajtim me këtë ligj.

(2) Organizatat mund të anëtarësohen në organizata tjera ndërkombëtare ose në mënyrë tjetër të bashkëpunojnë me ato.

(3) Organizatat të cilat bashkohen në lidhje ose formë tjetër të organizimit, me bashkimin nuk e humbin cilësinë e personit juridik.

5. Marrja e cilësisë së personit juridik (subjektivitetit juridik)

Neni 6

(1) Organizatat e marrin cilësinë e personit juridik me regjistrimin në regjistrin të cilin e mban Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Regjistri).

(2) Shoqatat dhe fondacionet nuk mund të transformohen në lloje tjera të personave juridikë.

6. Koha e veprimit të organizatës dhe lehtësimi

Neni 7

(1) Nëse me aktin për themelim, përkatësisht me statutin e organizatës nuk është përcaktuar kohëzgjatja e organizatës, konsiderohet se organizata është themeluar për kohë të pacaktuar.

(2) Organizatat kanë lehtësime tatimore dhe doganore, në pajtim me ligjin.

7. Emri i organizatës

Neni 8

(1) Çdo organizatë e regjistruar sipas dispozitave të këtij ligji, ka emër dhe emër të shkurtuar nëse ajo është e paraparë me statutin dhe është regjistruar në Regjistër.

(2) Emri dhe emri i shkurtuar i organizatës, dallohen qartë nga emrat e organizatave tjera të cilat janë të regjistruara në Regjistër.

(3) Në emrin e:

- shoqatës përmbahet fjala shoqatë, ose shprehje tjetër me kuptim të ngjashëm të përcaktuar me statutin e shoqatës,

- lidhjes përmbahet fjala lidhje, ose shprehje tjetër me kuptim të ngjashëm të përcaktuar me statutin e lidhjes dhe

- fondacionit përmbahet fjala fondacion, ose shprehje tjetër me kuptim të ngjashëm të përcaktuar me statutin e fondacionit.

(4) Për çështjet e emrit të cilat nuk janë të rregulluara me këtë ligj, zbatohen dispozitat nga ligji me të cilin rregullohet emri i firmës së shoqërisë tregtare.

8. Përdorimi i fjalës "Maqedoni" ose emri i njësisë së vetadministrimit lokal

Neni 9

(1) Fjala "Maqedoni" dhe fjalët e nxjerra nga ajo, si dhe shkurtesat e saj, mund të përmbahen në emrin e organizatës vetëm me leje të Ministrisë së Drejtësisë.

(2) Nëse në emrin e organizatës janë të përmbajtura fjalë me emrin e komunës, përkatësisht qytetit të Shkupit, leje jep organi kompetent i komunës, i komunave të qytetit të Shkupit dhe i qytetit të Shkupit.

II. PARIMET KRYESORE

1. Pavarësia

Neni 10

Organizatata janë të pavarura në udhëheqjen, përcaktimin dhe realizimin e qëllimeve dhe veprimeve të përcaktuara me statutin e tyre, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin.

2. Publiciteti dhe transparenca

Neni 11

(1) Puna e organizatës është publike.

(2) Publiciteti i punës së organizatës realizohet nëpërmjet publikimit transparent të statuteve dhe akteve të tjera të organizatës, në pajtim me statutin e organizatës.

3. Joprofitabiliteti

Neni 12

(1) Organizatat nuk mund të themelohen për arritjen e përfitimeve.

(2) Organizatat mund të kryejnë veprime me të cilat mund të përfitojnë, nëse veprimtaria lidhet me qëllimet e përcaktuara me statut.

(3) Nëse në punën e organizatave realizohet fitimi, ajo doemos duhet të përdoret për realizimin e qëllimeve të përcaktuara me statut.

(4) Fitimi i realizuar nga paragrafi (3) i këtij neni, nuk mund të ndahet ndërmjet themeluesve, anëtarëve, anëtarëve të organeve, drejtorëve, të punësuarve ose cilitdo person tjetër të lidhur me ato.

4. Veprimi jopartiak

Neni 13

(1) Organizatat nuk mund të kryejnë aktivitete të partisë politike, përkatësisht nuk mund të sigurojnë financim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të partisë konkrete politike dhe të ndikojnë në zgjedhje.

(2) Si ndikim në zgjedhje sipas paragrafit (1) të këtij neni, nënkuptohet pjesëmarrja e organizatave në zgjedhje dhe fushatë zgjedhore për parti të caktuara politike dhe financim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të fushatës zgjedhore të partisë politike.

5. Iniciativa në jetën publike

Neni 14

Organizatrat mundën lirisht t'i shprehin dhe promovojnë mendimet dhe qëndrimet e tyre për çështje në interes të tyre, të ngritin iniciativa dhe të marrin pjesë në ndërtimin e mendimit publik dhe krijimin e politikave.

III. SHOQATAT

1. Themeluesit

Neni 15

(1) Shoqatë mund të themelojnë persona fizikë dhe juridikë.

(2) Shoqatë mund të themelojnë më së paku pesë themelues, nga të cilët tre nga themeluesit doemos duhet të kenë vendbanim ose vendqëndrim, përkatësisht seli në territorin e Republikës së Maqedonisë.

(3) Shoqatë të qytetarëve mund të themelojnë edhe persona të mitur me moshë të mbushur 15-vjeçare, nëpërmjet deklaratës për pajtim për themelimin e shoqatës nga përfaqësuesi i tyre ligjor, për qëllimet për të cilat themelohet shoqata, në pajtim me ligjin.

2. Themelimi

Neni 16

(1) Shoqata themelohet në kuvend themelues.

(2) Në kuvendin themelues miratohet akti për themelim, programi, statuti dhe zgjidhen organet e shoqatës.

3. Akti për themelim

Neni 17

(1) Akti për themelimin e shoqatës, i përmban:

- emrin, selinë dhe adresën e shoqatës,
- emrin, adresën ose selinë dhe numrin unik të amzës të qytetarit, përkatësisht numrin unik tatimor të themeluesve të shoqatës dhe
- qëllimet e shoqatës.

(2) Akti për themelim ose pjesa e tij mundet të ndryshohet, nëse për këtë ka vullnet nga themeluesit, derisa zgjat procesi i regjistrimit.

4. Statuti dhe përmbajtja e statutit

Neni 18

(1) Shoqata ka statut.

(2) Me statutin e shoqatës rregullohen:

- emri dhe selia,
- qëllimet e shoqatës,
- veprimtaritë me të cilat realizohen qëllimet,
- mënyra e vendimmarrjes për anëtarësim, për përjashtim dhe për ndërprerje të anëtarësimit në shoqatë,
- të drejta, obligime dhe përgjegjësi të anëtarëve,
- lloji i organeve dhe përbërja e tyre, mënyra e zgjedhjes dhe e shkarkimit, kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve në organet dhe mënyra e vendimmarrjes,
- përfaqësimi sipas ligjit,
- mënyra e fitimit dhe disponimit me mjetet,
- mënyra e miratimit të raporteve financiare dhe të tjera,
- mënyra e realizimit të transparencës dhe dhënia e llogarisë për punën,

- mënyra e miratimit, ndryshimit dhe plotësimit të statutit,
- mënyra e vendimmarrjes për ndryshime statutare dhe shuarja e shoqatës,
- mënyra e miratimit të planeve dhe programeve,
- menaxhimi me mjetet dhe/ose pronën në rast të shuarjes së shoqatës dhe
- çështje të tjera të përcaktuara me ligj.

(3) Me statutin e shoqatës mund të rregullohen edhe:

- shenja dhe simboli i shoqatës,
- format e brendshme organizative (filialet, degët dhe ngjashëm), nëse i ka,
- mënyra e miratimit të akteve tjera,
- konflikt i interesave,
- mënyra e zgjidhjes së çështjeve kontestuese dhe
- çështje tjera të rëndësishme për punën e shoqatës.

5. Anëtarësimi në shoqatë

Neni 19

(1) Anëtarësimi në shoqatë është vullnetar.

(2) Themeluesit janë anëtarë të shoqatës me përgjegjësi dhe të drejta të barabarta, si dhe anëtarët e tjerë të shoqatës.

(3) Personi fizik mund të jetë anëtar i shoqatës pavarësisht nga mosha e tij, në pajtim me statutin.

(4) Personi i mitur që i ka mbushur 14 vjet, anëtarësohet në shoqatë me dhënien e deklaratës së nënshkruar për pajtimin e përfaqësuesit të tij ligjor, për anëtarësim në organizatë në pajtim me ligjin.

(5) Personat me aftësi të kufizuar për punë ose personat të cilëve u është hequr aftësia për punë, mund të bëhen anëtarë të shoqatës me dhënien e deklaratës së nënshkruar për pajtueshmëri të përfaqësuesit të tij ligjor, për anëtarësim në organizatë në pajtim me ligjin.

6. Regjistri i anëtarëve

Neni 20

(1) Shoqata mban regjistër të anëtarëve dhe evidencë të anëtarëve të organeve.

(2) Të dhënat nga paragrafi (1) të këtij neni azhurnohen së paku një herë në dy vjet.

(3) Shoqatat e garantojnë anonimitetin e të dhënave personale të anëtarëve të cilit atë e kanë kërkuar.

(4) Të dhënat nga paragrafi (1) të këtij neni janë të mbrojtura në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informatave të klasifikuara.

7. Udhëheqja e shoqatës

Neni 21

Me shoqatën udhëheqin anëtarët drejtpërdrejtë ose nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur në organet e shoqatës.

8. Kuvendi i Shoqatës

Neni 22

(1) Kuvendi është organi më i lartë i shoqatës dhe e përbëjnë të gjithë anëtarët.

(2) Me statut mund të përcaktohet mënyra e përfaqësimit të anëtarëve të shoqatës në Kuvendin e Shoqatës, nëpërmjet përfaqësuesve të saj të zgjedhur.

9. Kompetencat e kuvendit

Neni 23

Kuvendi:

- i miraton statutin, programin dhe aktet tjera,

- e miraton raportin vjetor për punën dhe raportin financiar dhe e shpall në ueb-faqen e tij;
- i dorëzon raport financiar organit kompetent të administratës shtetërore, përkatësisht organit të komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit në rastet kur shfrytëzon mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, përkatësisht buxhetet e njësisve të vetadministrimit lokal,
- vendos për ndryshimin e qëllimit të shoqatës,
- vendos për organizimin e brendshëm dhe format organizative të organeve të shoqatës,
- i zgjedh dhe shkarkon anëtarët e organeve,
- vendos për ndryshimet statusore të shoqatës,
- vendos për shuarjen e shoqatës me shumicën e dy të tretave të votave nga të gjithë anëtarët e shoqatës dhe
- kryen edhe punë tjera në pajtim me statutin dhe aktet e shoqatës.

10. Puna e kuvendit

Neni 24

- (1) Kuvendi punon në mbledhje.
- (2) Kuvendi, sipas rregullës, mbledhje mban më së paku një herë në vit, ndërsa me statutin e shoqatës mund të përcaktohet edhe afat më i shkurtë se një vit për mbajtjen e mbledhjes.
- (3) Mbledhje e jashtëzakonshme e kuvendit mund të mbahet me kërkesë me shkrim nga një e treta e anëtarëve të shoqatës.
- (4) Mbledhja e jashtëzakonshme e kuvendit nga paragrafi (3) e këtij neni mbahet më së voni në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës për mbajtje.
- (5) Mënyra e thirrjes së kuvendit, puna dhe miratimi i vendimeve, dhe vendimmarrja pa pjesëmarrje, rregullohet me statutin e shoqatës.

11. Përfaqësuesi i shoqatës

Neni 25

- (1) Shoqata ka një ose më shumë persona, të autorizuar për përfaqësimin e shoqatës (në tekstin e mëtejshëm: përfaqësues), të zgjedhur përkatësisht emëruar sipas mënyrës së përcaktuar me statut.
- (2) Përfaqësuesi i shoqatës mund të jetë person fizik me aftësi afariste i cili ka vendbanim në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me ligjin.
- (3) Të drejtat dhe obligimet përfaqësuesi i shoqatës i kryen në pajtim me ligjin, statutin dhe aktet e shoqatës.

12. Organet tjera të shoqatës

Neni 26

Me statutin e shoqatës mund të parashihen edhe organe tjera të shoqatës.

IV. FONDACIONET

1. Themelimi

Neni 27

- (1) Fondacioni është person juridik i formuar për realizimin e qëllimit me fitimin dhe udhëheqjen e pronës dhe mjetet në pajtim me ligjin.
- (2) Fondacioni themelohet me masë të pronës e cila arrin shumën së paku 10 000 euro në kundërvlerë me denarë, sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, të shprehur në para, letra me vlerë ose pronë tjetër në ditën e parashtrimit të aktit për regjistrim në Regjistër.
- (3) Nëse regjistrimi i fondacionit është përcaktuar me testament, kurse ajo nuk është regjistruar në afat prej 60 ditësh, masa e pronës shpërndahet në pajtim me ligjin.

2. Themeluesit e fondacionit

Neni 28

- (1) Fondacionin e themelojnë një ose më shumë persona.
- (2) Si themelues të fondacionit mund të paraqiten persona fizikë dhe juridikë.
- (3) Fondacioni themelohet me akt për themelim ose si vullnet i fundit i deklaruar me testament ose legat.

3. Akti për themelim

Neni 29

- (1) Akti për themelim të fondacionit i përmban:
 - emrin dhe selinë e fondacionit,
 - emrin, adresën ose selinë dhe numrin unik të amzës të qytetarit, ose numrin unik të amzës të themeluesit të fondacionit,
 - qëllimet e fondacionit dhe
 - lartësinë e masës së pronës me të cilën themelohet fondacioni e shprehur në para për çdo themelues veç e veç.
- (2) Akti për themelim mund të përmbajë edhe dispozita tjera për themelim dhe veprim të fondacionit, si dhe për të drejtën e themeluesit që të vendosë për ndryshimin e qëllimit, emrit, mënyrës së miratimit të ndryshimit dhe plotësimit të statutit dhe shuarjen e fondacionit.
- (3) Akti për themelim nënshkruhet nga themeluesit.

4. Pjesëmarrja në udhëheqje

Neni 30

Mënyra e pjesëmarrjes së themeluesit në udhëheqje me fondacionin, rregullohen me statutin e fondacionit.

5. Statuti dhe përmbajtja e statutit

Neni 31

- (1) Fondacioni ka statut.
- (2) Me statut rregullohen:
 - emri dhe selia e fondacionit,
 - qëllimet e fondacionit,
 - veprimtaria me të cilën realizohen qëllimet e fondacionit,
 - organizimi i brendshëm, lloji dhe përbërja e organeve, kompetencat, mënyra e zgjedhjes dhe shkarkimi i anëtarëve të komisionit, kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të organeve dhe mënyra e vendimmarrjes,
 - përfaqësimi ligjor,
 - mënyra e fitimit dhe disponimi i mjeteve,
 - mënyra e miratimit të raporteve afariste, financiare dhe të tjera,
 - mënyra e realizimit të publicitetit dhe transparencës në punë,
 - mënyra e miratimit, ndryshimit dhe plotësimit të statutit,
 - mënyra e vendimmarrjes për ndryshimet statusore dhe shuarja e fondacionit,
 - veprimi me mjetet e fondacionit në rast të shuarjes së fondacionit,
 - mënyra e miratimit të planeve dhe programeve dhe
 - çështjet e tjera të përcaktuara me ligj.
- (3) Me statutin e fondacionit mund të rregullohen edhe:
 - shenja dhe simboli i fondacionit,
 - format organizative të brendshme të fondacionit (filialet, degët dhe ngjashëm), nëse fondacioni i ka,
 - mënyra e miratimit të akteve tjera,

- konflikti i interesave dhe
- çështjet tjera të rëndësishme për punën dhe mënyra e zgjidhjes së çështjeve kontestuese të fondacioneve.

6. Personi përgjegjës për miratimin e statutit

Neni 32

(1) Statuti është i përbërë dhe i miratuar në pajtim me themeluesit, nëse me aktin për themelim nuk është përcaktuar ndryshe.

(2) Nëse fondacioni është themeluar me deklaratë në pajtim me nenin 28 paragrafi (3) të këtij ligji, statutin e përpilon përmbaruesi i testamentit, përkatësisht legati, vetëm nëse me deklarinimin e fundit të vullnetit nuk është përcaktuar ndryshe.

7. Organet e fondacionit

Neni 33

(1) Fondacioni ka këshill dhe drejtor.

(2) Me statutin e fondacionit mund të parashihen edhe organe të tjera.

8. Këshilli i Fondacionit

Neni 34

(1) Këshilli është organi më lartë i udhëheqjes së fondacionit.

(2) Themeluesi gjatë themelimit të fondacionit emëron Këshillin e Fondacionit, vetëm nëse me aktin për themelim ose statutin nuk është përcaktuar ndryshe.

(3) Këshilli i Fondacionit punon në mënyrën e përcaktuar me statutin e fondacionit.

9. Kompetencat e këshillit

Neni 35

(1) Këshilli i Fondacionit:

- miraton statut, program dhe akte të tjera,
- miraton raport vjetor për punë dhe raport financiar dhe e shpall në ueb-faqen e tij,
- i dorëzon raport financiar organit kompetent të administratës shtetërore, përkatësisht organit të komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit në rastet kur shfrytëzon mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, përkatësisht buxhetet e njësisve të vetadministrimit lokal,

- vendos për ndryshimin e qëllimit të fondacionit,

- vendos për organizimin e brendshëm dhe format organizative të fondacionit,

- zgjedh dhe shkarkon anëtarë të organeve,

- vendos për ndryshimet statusore të fondacionit,

- vendos për shuarjen e fondacionit dhe

- kryen edhe punë të tjera në pajtim me statutin dhe aktet e fondacionit.

(2) Këshilli i fondacionit i ka të drejtat nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse me aktin për themelim ose me statutin e fondacionit, themeluesi nuk i ka mbajtur për vete këto të drejta.

10. Udhëheqja me fondacionin

Neni 36

(1) Me fondacionin udhëheq drejtor.

(2) Fondacioni mund të ketë një ose më shumë drejtorë të autorizuar për përfaqësimin e fondacionit, të zgjedhur në mënyrë të përcaktuar me statutin.

(3) Drejtori mund të jetë person fizik me aftësi afariste i cili ka vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Maqedonisë.

(4) Drejtori të drejta e tij, obligimet dhe përgjegjësitë i kryen në pajtim me këtë ligj, statutin dhe aktet e fondacionit.

V. FORMAT ORGANIZATIVE TË ORGANIZATAVE TË HUAJA

1. Person i huaj dhe organizatat e huaja

Neni 37

(1) Si themelues dhe anëtarë të organizatës në pajtim me këtë ligj mund të jenë edhe persona të huaj.

(2) Personat nga paragrafi (1) të këtij neni i kanë të drejtat e njëjta dhe obligimet, si dhe personat vendas, vetëm nëse me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

2. Organizata e huaj

Neni 38

(1) Organizatat e huaja mund të veprojnë në Republikën e Maqedonisë nëpërmjet të filialeve, zyrave ose formave të tjera organizative të organizatave të huaja të cilat kanë seli në territorin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Në Republikën e Maqedonisë organizatat e huaja punojnë në pajtim me dispozitat e këtij ligji vetëm nëse me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuar nuk është përcaktuar ndryshe.

3. Akti për themelim

Neni 39

(1) Format organizative të organizatave të huaja themelohen me aktin e organizatës së huaj për themelimin e saj në Republikën e Maqedonisë.

(2) Akti nga paragrafi (1) i këtij ligji përmban:

- emrin dhe selinë e organizatës së huaj e cila themelon formë organizative,
- qëllimin e organizatës së huaj dhe qëllimin e formës organizative të organizatës së huaj dhe
- emrin dhe selinë e formës organizative të organizatës së huaj.

(3) Aktin nga paragrafi (1) të këtij neni e cakton personi i autorizuar i organizatës së huaj dhe verifikohet në noter.

VI. REGJISTRIMI

1. Regjistrat

Neni 40

(1) Regjistri mban:

- regjistër të shoqatave dhe regjistër të lidhjeve,
- regjistër të fondacioneve dhe
- regjistër të formave organizative të organizatave të huaja.

(2) Regjistrat nga paragrafi (1) të këtij neni mbahen në formë të shkruar dhe si bazë elektronike qendrore unike e të dhënave të cilat shpallen në ueb faqen e Regjistratit dhe regjistrohen në Regjistrin e personave tjerë juridikë.

(3) Formën, përmbajtjen dhe mënyrë e regjistrimit dhe mbajtjes së regjistrave nga paragrafi (1) të këtij neni, i përcakton ministri i Drejtësisë.

2. Përmbajtja e regjistrave

Neni 41

(1) Në regjistrat regjistrohen:

- emri i plotë i organizatës dhe emri i shkurtuar nëse e ka,
- selia,
- akti për themelim,
- data e themelimit;
- emri, mbiemri dhe numri unik i amzës i qytetarit dhe numri unik i amzës i themeluesve,

- data e miratimit, përkatësisht ndryshimit dhe plotësimit të statutit,
- koha e paraparë për të cilën organizata themelohet,
- qëllimet dhe veprimet,
- emri, mbiemri dhe numri i amzës së përfaqësuesit sipas ligjit,
- të dhëna për njësitë organizative (filiale, zyra dhe të ngjashme),
- të dhëna për statusin e organizatës me interes publik,
- të dhëna për ndryshime statusore,
- të dhëna për falimentim dhe likuidim,
- vërejtje për fillimin e procedurës për ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë,
- shuarja e punës dhe
- numri dhe data e aktvendimit për regjistrim, për ndryshimin e të dhënave dhe aktvendim për shlyerjen e regjistrimit në regjistrin përkatës nga neni 40 paragrafi (1) i këtij ligj.

(2) Për fondacionet përveç të dhënave nga paragrafi (1) të këtij neni, regjistrohet edhe masa e pronës fillestare.

(3) Për format organizative të organizatave të huaja regjistrohet edhe:

- shteti në të cilin është regjistruar organizata e huaj dhe selia e organizatës në atë shtet dhe
- emri i formës organizative dhe lloji i organizatës së huaj.

(4) Për organizatat me status me interes publik regjistrohet emri, mbiemri dhe numri i amzës i anëtarëve të organit për mbikëqyrje.

3. Regjistrimi në Regjistër

Neni 42

(1) Regjistrimi në regjistër bëhet me fletëparaqitje për regjistrim e cila parashtrohet në afat prej 30 ditësh nga dita e miratimit të aktit për themelim, përkatësisht aktvendimin e organizatës së huaj për themelimin e formës organizative të organizatës së huaj në Republikën e Maqedonisë.

(2) Fletëparaqitjen për regjistrim e parashton përfaqësuesi.

(3) Për regjistrimin, nga paragrafi (1) të këtij neni, në regjistër, shoqatat dhe fondacionet parashtrojnë:

- akti për themelim,
- statuti,
- programi për veprim,
- vendimi për zgjedhjen e organeve dhe të dhëna për anëtarët e organeve,
- vendimi për zgjedhjen e përfaqësuesit sipas ligjit me të dhënat e ti,;
- procesverbali nga kuvendi themelor ose raport për themelimin dhe
- deklaratë të verifikuar në noter e nënshkruar nga përfaqësuesi, me të cilën vërtetohet se kryerja e veprimtarisë është në pajtim me ligjin dhe se janë plotësuar kushtet për regjistrim;

(4) Për regjistrim në regjistër të formës organizative të organizatës së huaj me fletëparaqitjen parashtrohen:

- kopje e verifikuar e aktit për themelimin e organizatës së huaj dhe përkthim i verifikuar për regjistrimin në shtetin e huaj në të cilin është themeluar ose dokument tjetër i cili vërteton se organizata mund të veprojë,
- kopje e verifikuar e aktvendimit dhe përkthim i verifikuar i aktvendimit të organit kompetent për themelimin e formës organizative në Republikën e Maqedonisë,
- kopje dhe përkthim i verifikuar i statutit ose aktit tjetër përkatës,
- program për veprim në Republikën e Maqedonisë,
- vendim i verifikuar dhe përkthim për zgjedhjen e organeve me të dhëna personale të anëtarëve të cilët marrin pjesë në organet,
- përkthim i verifikuar i vendimit dhe vendimit për zgjedhjen e përfaqësuesit ligjor me të dhëna personale, kopje të verifikuar të dokumentit të identifikimit të atij personi dhe dokument për vendqëndrim të rregulluar, përkatësisht vendbanim në Republikën e Maqedonisë dhe

- përkthim i verifikuar i vendimit për person të autorizuar nga përfaqësuesi ligjor për regjistrimin e formës organizative të organizatës së huaj në Republikën e Maqedonisë.

4. Aktvendimi për regjistrim

Neni 43

(1) Regjistri është i obliguar që në afat prej pesë ditësh nga dita e parashtrimit të fletëparaqitjes për regjistrim të miratojë aktvendim për regjistrim në regjistrin përkatës nga neni 40 paragrafi (1) të këtij ligji.

(2) Aktvendimin për regjistrim në regjistrin përkatës nga neni 40 paragrafi (1) të këtij ligji, i dorëzohet parashtruesit të fletëparaqitjes në afat prej tre ditësh nga dita e miratimit të aktvendimit.

(3) Me aktvendimin për regjistrim në regjistër dorëzohet kopje nga statuti i verifikuar me vulë të Regjistrit.

(4) Me regjistrimin në regjistrin përkatës nga neni 40 paragrafi (1) të këtij ligji, organizata fiton cilësi të personit juridik.

5. Plotësimi dhe refuzimi

Neni 44

(1) Nëse Regjistri vërteton se fletëparaqitja për regjistrim në regjistrin përkatës nga neni 40 paragrafi (1) të këtij ligji, nuk është në pajtim me nenin 42 të këtij ligji do t'i bëjë vërejtje për atë parashtruesit të kërkesës dhe do të caktojë afat prej 30 ditësh në të cilin është i obliguar të veprojë sipas vërejtjes.

(2) Nëse në afatin e caktuar parashtruesi i kërkesës për regjistrim nuk vepron sipas vërejtjes, Regjistri me aktvendim do ta refuzojë kërkesën për regjistrim në regjistrin përkatës nga neni 40 paragrafi (1) të këtij ligji.

6. E drejta për ankesë

Neni 45

Kundër aktvendimit të Regjistrit me të cilën është refuzuar kërkesa për regjistrim në regjistrin përkatës nga të nenit 40 paragrafi (1) të këtij ligji, organizata ka të drejtë për ankesë në Komisionin për Ankesa, të përcaktuar me Ligjin për sistem njësportel dhe për mbajtjen e regjistrit tregtar dhe regjistrin të personave tjerë juridikë, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i aktvendimit.

7. Regjistrimi për ndryshimin e të dhënave

Neni 46

(1) Organizatat të cilat kanë kryer ndryshim të të dhënave të cilat regjistrohen në regjistrin përkatës nga neni 40 paragrafi (1) nga ky ligj, janë të obliguar që në afat prej 30 ditësh nga dita e ndryshimeve të bëra të parashtrojnë fletëparaqitje në Regjistër për regjistrimin e ndryshimeve.

(2) Fletëparaqitje për ndryshimet e bëra parashtron përfaqësuesi.

(3) Për regjistrimin e ndryshimeve të të dhënave në regjistrin përkatës nga neni 40 paragrafi (1) të këtij ligji, zbatohen dispozitat për regjistrim të përcaktuara me këtë ligj.

8. Publiciteti i regjistrit

Neni 47

Të dhënat në regjistrin përkatës nga neni 40 paragrafi (1) nga ky ligj janë publike, dhe shpallen në ueb faqen e Regjistrit.

VII. MJETET PËR PUNËN E ORGANIZATAVE

1. Burimet e financimit

Neni 48

Organizatata, mjetet për financim i marrin nga anëtarësia, investimet themeluese, kontributet vullnetare, donacionet, dhuratat (në para, të mira, të drejta pronësore), pasuri të lëna me testament, legata, veprimtari me të cilat arrihet përfitimi, qiratë dhe qiramarrja, si dhe të hyra nga investimet, dividendët, kamatat, borxhet dhe të hyra të tjera në pajtim me ligjin dhe me statutin.

2. Mjete nga buxhetet

Neni 49

(1) Organizatat mund të fitojnë mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, buxhetet e komunave, komunat e qytetit të Shkupit dhe qyteti i Shkupit.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe këshillat e komunave, këshillat e komunave të qytetit të Shkupit dhe këshilli i qytetit të Shkupit më së afërmi i rregullojnë kushtet për shpërndarje dhe shfrytëzimin e mjeteve nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Qeveria e Republikës së Maqedonisë, përkatësisht organet kompetente të administratës shtetërore dhe komunat, komunat e qytetit të Shkupit dhe qyteti i Shkupit miratojnë plane dhe programe vjetore për shpërndarjen e mjeteve nga paragrafi (1) të këtij neni.

(4) Organet e administratës shtetërore, komunat, komunat e qytetit të Shkupit dhe qyteti i Shkupit në ueb-faqet e tyre i shpallin organizatat të cilat i kanë marrë mjete nga paragrafi (1) të këtij neni, si dhe qëllimet e organizatave për të cilat i kanë fituar ato mjete.

(5) Organizatat që kanë marrë mjete nga paragrafi 1 i këtij neni, parashtrojnë raport pune dhe financiar te organi kompetent i administratës shtetërore, përkatësisht organi i komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe qytetit të Shkupit, në rastet kur shfrytëzojnë mjete nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, përkatësisht buxhetet e njërive të vetadministrimit lokal.

(6) Lehtësimet tatimore dhe doganore, nuk mund të zbatohen për mjete që i ka shfrytëzuar organizata, në kundërshtim me nenet 12 dhe 13 të këtij ligji.

3. Përdorimi i mjeteve

Neni 50

(1) Mjetet financiare të organizatave përdoren për realizimin e qëllimeve të organizatës të caktuara me statutin dhe programin.

(2) Anëtarët e organeve të organizatave dhe përfaqësuesit e tyre sipas ligjit janë të obliguara që të menaxhojnë dhe punojnë me vëmendje dhe në pajtim me parimet e udhëheqjes së mirë, në interes të organizatës dhe mbi interesat personale, përkatësisht në interes të realizimit të qëllimeve, në pajtim me ligjin dhe statutin.

(3) Mjetet e organizatës nuk mund t'u paguhet anëtarëve, themeluesve, anëtarëve të organeve, përfaqësuesve, të punësuarve ose personave të lidhur me to, përveç në rast kur anëtari i organizatës është shfrytëzues i shërbimeve të organizatës në pajtim me qëllimet e caktuara me ligjin dhe programin e organizatës.

(4) Puna në organet e organizatës sipas rregullës është vullnetare, ndërsa anëtarët e organeve të organizatave mund të marrin kompensime të harxhimeve rrugore dhe ditore si dhe kompensim për kryerjen e punëve në organet e organizatës në pajtim me ligjin.

(5) Të punësuarit kanë të drejtë për rrogë dhe kompensime, në pajtim me ligj dhe marrëveshje kolektive.

4. Përgjegjësia për obligimet

Neni 51

(1) Organizatat përgjigjen për obligimet e tyre me gjithë mjetet dhe pronën e tyre.

(2) Anëtarët e organeve të organizatave përgjigjen personalisht dhe pa kufizime, për obligimet e tyre ndaj organizatës, për keqpërdorimin e mjeteve të organizatës, për arritjen e qëllimeve që për to si individë janë të ndaluara ose për keqpërdorimin e organizatës si person juridik që t'u shkaktojnë dëm kreditorëve të tyre.

5. Përgjegjësia për dëmin

Neni 52

(1) Anëtarët e organeve të organizatave dhe përfaqësuesit e tyre me ligj përgjigjen në mënyrë solidare për dëmin e organizatës të shkaktuar nga puna e tyre, nëse ajo është shkaktuar me pakujdesi brutale, ose me qëllim që të shkaktohet dëm, vetëm në rastet kur në vendimmarrje e kanë veçuar mendimin e tyre të përfaqësuesit ose nëse nuk kanë marrë pjesë në vendimmarrje.

2) Kërkesë për kompensimin e dëmit parashtrohet organi i caktuar me statut, ose organi më i lartë, nëse me statut nuk është përcaktuar organ.

6. Raportet e punës

Neni 53

(1) Organizatat janë të obliguara që në ueb faqen e tyre ose në mënyrë tjetër t'i shpallin raportet vjetore për punën e tyre.

(2) Organizatat janë të obliguara që të përgatitin raport financiar vjetor, t'ia dorëzojnë organit kompetent në pajtim me ligjin dhe ta shpallin në ueb lokacionin e tyre, ose në mënyrë tjetër përkatëse ta bëjnë të kapshme për publikun.

(3) Raportet nga paragrafi (1) dhe paragrafi (2), organizatat janë të obliguara që t'i shpallin më së voni deri më 30 prill për vitin paraprak.

7. Disponimi me mjetet në rast të shuarjes

Neni 54

(1) Në rast të shuarjes së punës së organizatës, mjetet që mbeten pas shlyerjes së obligimeve, shfrytëzohen në mënyrë të përcaktuar me statut.

(2) Nëse me statut nuk është përcaktuar pranuesi i mjeteve që mbeten pas shlyerjes së obligimeve nga paragrafi 1 të këtij neni, ato mjete u barten komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit në rajonin e të cilëve ka seli organizata.

(3) Në rast të shuarjes së organizatës me status me interes publik, mjetet i barten organizatës tjetër me status me interesit publik me qëllim të njëjtë ose të ngjashëm të veprimit ose komunës në rajonin e të cilit ka seli organizata, për çka vendosë dhënësi i mjeteve.

8. Bartja e mjeteve në rast të ndalimit të punës

Neni 55

Kur me vendim të gjyqit kompetent ndalohet puna e organizatës, prona e organizatës u bartet komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit, në rajonin e të cilit ka seli organizata.

VIII. MBIKËQYRJE

1. Organi për mbikëqyrje

Neni 56

(1) Organizatat mund të kenë organ për mbikëqyrje.

(2) Organi për mbikëqyrje e ndjek zbatimin e statutit dhe programit, kujdeset për punën dhe pronën e organizatës dhe kryen punë të tjera në mënyrën e përcaktuar me ligj.

2. Kompetenca për kryerjen e kontrollit

Neni 57

(1) Anëtarët e organizatës, kryejnë kontroll të punës së organeve të organizatave.

(2) Nëse anëtarët e organizatës ose anëtarët e organeve të organizatës kuptojnë për parregullsi në zbatimin e statutit, ose në punën financiare, mund të kërkojnë mënjanimin e parregullsisë nga organi i përcaktuar me statut, përkatësisht organi më i lartë nëse me statut nuk është caktuar organ tjetër.

3. Mbikëqyrja

Neni 58

Mbikëqyrje të ligjshmërisë së zbatimit të dispozitave të këtij ligji, kryen Ministria e Drejtësisë.

IX. NDRYSHIME STATUSORE

1. Nocioni dhe lloji i ndryshimeve statusore

Neni 59

Ndryshimi statusor nënkupton bashkim, bashkëngjitje dhe ndarje të organizatës, të bërë në bazë të vendimit të miratuar nga organi në pajtim me këtë ligj dhe statutin.

2. Bashkim i organizatës

Neni 60

(1) Bashkimi është bartje e të drejtave dhe obligimeve të një organizate (organizatë e cila bashkohet) në organizatë tjetër (organizatë e cila merr), në bazë të vendimit dhe marrëveshjes për bashkim.

(2) Marrëveshja për bashkim i përmban emrat dhe selinë e organizatave, mënyrën për bartjen e pronës së organizatës e cila bashkohet me përshkrim të të drejtave dhe obligimeve të cilat barten.

(3) Bashkimi i një ose më shumë organizatave në tjetër regjistrohet në Regjistrin qendror.

(4) Për regjistrimin e bashkimit adekuat zbatohen dispozitat për regjistrim në regjistër, të përcaktuar me këtë ligj.

(5) Me fletëparaqitjen për regjistrim parashtrihen edhe vendimet nga organizatat të cilat marrin pjesë në bashkimin për pranimin e marrëveshjeve të lidhura për bashkim, në tekstin përkatës, marrëveshja për bashkim dhe aktvendim për regjistrim në regjistrin e organizatave të cilat bashkohen.

(6) Me regjistrimin për bashkim në regjistër pushon të ekzistojë organizata që bashkohet.

3. Bashkëngjitja e organizatave

Neni 61

(1) Bashkëngjitja është themelimi i organizatës së re në të cilën kalojnë të gjitha të drejtat dhe obligime të dy ose më shumë organizatave të cilat bashkëngjiten.

(2) Me bashkëngjitjen pushojnë të ekzistojnë organizatat të cilat janë bashkëngjitur, ndërsa organizata e sapokrijuar llogaritet si organizatë të re.

(3) Për organizatën e re, përkatësisht përdoren dispozitat për themelimin e organizatës në pajtim me këtë ligj.

4. Ndarja e organizatave

Neni 62

(1) Organizata mund të ndahet në dy ose më shumë organizata.

(2) Vendimi për ndarjen e organizatës ka fuqi juridike të aktit për themelim.

(3) Organizata e ndarë pushon të ekzistojë, ndërsa në procedurën për regjistrimin e organizatave të sapokrijuara zbatohen dispozitat për regjistrim në pajtim me këtë ligj.

(4) Organizatat e krijuara me ndarjen me ditën e regjistrimit në regjistrin përgjigjen në mënyrë solidare për obligimet e organizatës së ndarë.

(5) Me kërkesën për regjistrim në regjistër parashtrohet edhe bilanc ndarës.

X. SHUARJA DHE NDALIMI I ORGANIZATËS

1. Shuarja e organizatës

Neni 63

(1) Organizata pushon të ekzistojë, nëse:

- është miratuar vendim për shuarjen e ekzistimit, në pajtim me statutin,
- koha e kaluar dyfish më shumë nga koha e paraparë për mbajtjen e mbledhjes së organit më të lartë të përcaktuar me statut, ndërsa ajo nuk është mbajtur,
- për dy vite të njëpasnjëshme nuk është parashtruar llogari përfundimtare në pajtim me ligjin,
- ka kaluar koha e caktuar me statut, kur themelimi i organizatës është për kohë të caktuar,
- është ndryshim statusor i cili parasheh pushim të ekzistimit,
- është miratuar vendim i gjykatës kompetente,
- falimentim dhe
- është realizuar likuidim.

(2) Organizata mund të shuhet edhe nëse numri i anëtarëve të organizatës zvogëlohet nën numrin e caktuar për themelim.

2. Ngritja e procedurës për shuarje të organizatës

Neni 64

(1) Vendim për shuarje të organizatës në bazë të nenit 63, paragrafi (1) alinetë 2, 3 dhe 4 dhe paragrafi (2) të këtij ligji, miraton gjykata kompetente, me propozim të përfaqësuesit ligjor, anëtarëve të organeve, ose anëtarëve, në rastet kur nuk është miratuar vendim për shuarje të ekzistimit nga organi i përcaktuar me statut.

(2) Procedura për shuarje të organizatës para gjykatës kompetente mbahet sipas dispozitave të Ligjit për procedurë kontestimore.

(3) Për shuarje të organizatës gjykata me detyrë zyrtare e lajmëron Regjistrin.

3. Ndalimi i punës së organizatës

Neni 65

Ndalohet puna e organizatës nëse:

- veprimi i saj është i drejtuar në rrëzimin e dhunshëm të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë,
- nxitjen dhe thirrjen në agresion ushtarak dhe nxitjen e mosdurimit ose urrejtjes nacionale, racore ose fetare,
- aktivitete të lidhura me terrorizmin,
- ndërmerr aktivitete të cilët janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe ligjin dhe
- cenohen liritë dhe të drejtat e personave të tjerë.

4. Ngritja e procedurës për ndalim të punës së organizatës

Neni 66

(1) Çdokush mund të parashtojë iniciativë për ndalim të punës së organizatave para prokurorit publik kompetent.

(2) Nëse prokurori publik kompetent i shkallës së parë sipas selisë së organizatës me detyrë zyrtare ose pas iniciativës së parashtruar, vlerëson se ekzistojnë arsye për ndalim të punës të organizatës në pajtim me këtë ligj, do të parashtojë propozim në gjykatën kompetente.

(3) Procedura për ndalim është urgjente.

5. E drejta e ankesës

Neni 67

(1) Kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore për ndalim të punës së organizatës mund të parashtrahet ankesë në gjykatën kompetente të apelit në afat prej pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

(2) Gjykata Themelore ankesën e dorëzon në Gjykatën e Apelit në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të ankesës.

(3) Gjykata e Apelit pas ankesës vendos në afat prej tetë ditësh nga dita e marrjes së ankesës.

6. Likuidimi

Neni 68

(1) Likuidimi i organizatës realizohet kur organizata ka mjete të mjaftueshme financiare për mbulimin e obligimeve të saj, ndërsa është miratuar vendim (akt) për pushim të ekzistimit nga organi i përcaktuar me statut.

(2) Për çështjet e procedurës për likuidim të cilat nuk rregullohen me këtë ligj zbatohen dispozitat nga ligji me të cilin rregullohen çështjet për likuidim të shoqatave tregtare.

(3) Procedura për likuidim është urgjente.

7. Udhëheqja me organizatën në likuidim

Neni 69

(1) Me organizatën në likuidim udhëheq likuidatori.

(2) Likuidatori emërohet në mënyrë të rregulluar me statutin e organizatës ose i përcaktuar me vendimin për pushim të ekzistimit të organizatës.

(3) Me emërimin e likuidatorit përfundojnë autorizimet e organeve dhe të përfaqësuesit.

(4) Përfaqësimi i bartet likuidatorit me ditën e hapjes së procedurës për likuidim.

(5) Vendimi për shuarje me likuidim dhe për emërim të likuidatorit, dorëzohet në Regjistër në afat prej tre ditësh nga dita e miratimit të tij.

(6) Në Regjistër regjistrohen të dhënat për likuidatorin, ndërsa në emrin e organizatës shkruhet shenja "në likuidim".

8. Procedura e shkurtuar për likuidim

Neni 70

(1) Organizata mund të shuhet me procedurë të shkurtuar për likuidim, nëse pas miratimit të vendimit për pushim të ekzistimit nga organi i caktuar me statut, më shumë anëtarë të kuvendit ose përfaqësues të fondacionit dhe të organizatës së huaj, parashtrojnë në Regjistër deklaratë të verifikuar në pajtim me ligjin, se janë shlyer të gjitha obligimet ndaj kreditorëve dhe ndaj të punësuarve në organizatë.

(2) Personat nga paragrafi (1) të këtij neni përgjigjen në mënyrë solidare për obligimet e organizatës në afat prej tre vitesh nga dita e shlyerjes nga Regjistri.

(3) Organizata e cila shuhet me procedurë të shkurtuar shlyhet nga Regjistri, ndërsa shkruhen emrat dhe vendbanimi, përkatësisht selia e personave nga paragrafi (1) të këtij neni, me emblemë për përgjegjësinë e tyre në mënyrë solidare për obligimet e organizatës.

9. Procedurë pas likuidimit të realizuar dhe falimentimit

Neni 71

(1) Me mjetet që mbeten pas shlyerjes së obligimeve, likuidatori vepron në pajtim me këtë ligj dhe statutin e organizatës.

(2) Pas dorëzimit të mjeteve pranuesit, likuidatori parashtron kërkesë për shlyerje nga Regjistri, me të cilën dorëzon edhe raport për likuidimin ose për falimentimin dhe deklaratë se të gjitha mjetet janë ndarë në pajtim me ligjin dhe statutin.

(3) Procedura për falimentimin e organizatave zbatohet në pajtim me ligjin.

10. Shlyerja nga regjistri

Neni 72

- (1) Organizata shlyhet nga regjistri në bazë të likuidimit përfundimtar ose falimentimit.
- (2) Me shlyerje nga Regjistri organizata pushon të ekzistojë si person juridik.

XI. STATUSI I ORGANIZATËS ME INTERES PUBLIK

1. Nocioni i statusit me interes publik

Neni 73

Organizatat mund të fitojnë status me interes publik, nëse kryejnë veprimtari me interes publik, zbatojnë programe dhe projekte në nivel qendror dhe/ose në nivel lokal, individualisht ose në bashkëpunim me organet e administratës shtetërore dhe organet e komunave, komunitet e qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit si dhe shfrytëzimin e mjeteve financiare për realizimin e aktiviteteve.

2. Veprimtaria me interes publik

Neni 74

Veprimtari me interes publik janë:

- zhvillimi i demokracisë, shoqërisë civile dhe i të drejtave të njeriut,
- ndihma dhe mbrojtja e personave me hendikep fizik ose mental, persona me pengesa në zhvillim dhe persona me nevoja të posaçme,
- mbrojtja e fëmijëve dhe të rinjve,
- mbrojtja e personave të marginalizuar dhe përfshirja e tyre sociale,
- mbrojtja nga keqpërdorimi i drogës, sëmundjet ngjitëse seksuale, delikuenca e të miturve, alkoolizmi, prostitucioni dhe tregtia me njerëz,
- shëndetësia, përparimi i shëndetit dhe kujdesi mjekësor,
- art, kulturë dhe mbrojtje e trashëgimisë kulturore,
- sporti amator,
- mbrojtja e mjedisit jetësor dhe zhvillimi i qëndrueshëm,
- zhvillimi lokal dhe infrastrukturor,
- shkenca, arsimit dhe trajnimi në procesin arsimor,
- zhvillimi i etikës dhe i moralit;
- ndihma humanitare dhe sociale, zvogëlimi i varfërisë,
- ballafaqimi me fatkeqësitë elementare,
- mbrojtja dhe kujdesi për kafshët,
- mbrojtja e konsumatorëve,
- përparimi i bamirësisë dhe vullnetarizmit dhe
- veprimtari tjetër me interes publik të caktuar me këtë ose me tjetër ligj.

3. Kriteret për interes publik

Neni 75

Shoqata ose fondacioni do të fitojë status të organizatës me interes publik nëse:

- është regjistruar në pajtim me dispozitat e këtij ligji,
- veprimtaria me interes publik është shifra kryesore e të hyrave në punën e saj,
- puna dhe veprimi i drejtohet publikut më të gjerë dhe interesave të bashkësisë,
- ka strukturë organizative të nevojshme në pajtim me këtë ligj,
- ka kapacitete kadrovike të nevojshme për veprimtari, në pajtim me ligjin,
- ka resurse financiare përkatëse, përkatësisht vlerë të përgjithshme të pronës ose të hyrat vjetore nga minimum 1.500 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë,

- ka caktuar rregulla për konflikt interesash dhe për sigurimin e transparencës dhe publicitetit në punë dhe
- nuk është në falimentim ose likuidim dhe nuk ka xhiro-llogari të bllokuar.

4. Kërkesa

Neni 76

(1) Shoqata ose fondacioni parashtron kërkesë për fitimin e statusit të organizatës me interes publik në Komisionin për organizata me status të interesit publik.

(2) Me kërkesë parashtrohet edhe:

- aktvendimi për regjistrim në Regjistër,
- statut,
- programi për punë për vitin rrjedhës,
- përshkrimi i veprimtarisë me interes publik të definuar me statutin dhe aktivitetet me të cilin është zbatuar,
- rekomandimi nga organizata ose institucione me të cilat kanë bashkëpunuar,
- përshkrimi i strukturës organizative,
- përshkrimi i kapacitetit kadrovik të nevojshëm për veprimtari, në pajtim me ligjin,
- deklaratë për konflikt interesash nga procesverbali,
- informatë për situatën ekonomike dhe financiare të organizatës,
- llogaria përfundimtare, nëse shoqata ose fondacioni e ka rumbullakuar një cikël fiskal,
- vërtetimi se nuk është hapur procedurë për likuidim dhe
- vërtetimi se me vendim të plotfuqishëm nuk është shqiptuar masa e sigurisë - ndalim për kryerje të veprimtarisë.

(3) Dokumentet nga paragrafi (2) të këtij neni nuk guxojnë të jenë më të vjetër se gjashtë muaj dhe dorëzohen në origjinal ose kopje të verifikuar në noter.

(4) Statusi me interes publik nuk tejbartet në organizatat e krijuara me ndryshime statusore.

5. Organi për mbikëqyrje

Neni 77

(1) Organizata me interes publik ka organ për mbikëqyrje.

(2) Organi për mbikëqyrje:

- e ndjek zbatimin e statutit dhe programin e organizatës,
- kujdeset për punën dhe pronën e organizatës,
- e kontrollon mënyrën e punës së organit të udhëheqjes,
- parashtron raport në kuvendin e shoqatës, përkatësisht në këshillin e fondacionit dhe në organin nga i cili i janë bartur autorizimet publike më së paku një herë në vit për punën financiare dhe kontabiliste,
- e kontrollon llogarinë vjetore përfundimtare dhe aktet e tjera të organizatës dhe
- kryen punë të tjera të përcaktuara me ligjin dhe statutin.

6. Mospërputhja e funksioneve

Neni 78

(1) Anëtarët e organit për mbikëqyrje nuk mund të jenë anëtarë të organeve të tjera mbi punën e të cilave kryejnë mbikëqyrje.

(2) Të punësuarit në organizatë nuk mund të jenë anëtarë të organit për mbikëqyrje.

7. Caktimi i organizatave me status me interes publik

Neni 79

(1) Statusin e organizatave me interes publik, e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë me propozim të Komisionit për organizata me status me interes publik (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

(2) Komisionin nga paragrafi (1) të këtij neni, e formon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.,

(3) Komisioni është i përbërë nga kryetari dhe dhjetë anëtarë prej të cilëve nga një përfaqësues nga Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Kulturës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Vetadministrimit Lokal, Agjencia për të Rinj dhe Sport si dhe dy përfaqësues të organizatave të regjistruara në pajtim me këtë ligj.

(4) Mënyrën dhe kriteret e zgjedhjes si dhe shkaqet për shuarjen e kryerjes së punës së kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit nga paragrafi (3) i këtij neni, i rregullon ministri i Drejtësisë me akt nënligjor.

(5) Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të Komisionit është katër vjet.

8. Kompetenca të Komisionit

Neni 80

(1) Komisioni i kryen punët në vijim:

- jep propozime për dhënien dhe pushimin e statusit të organizatës me interes publik,
 - shqyrton dhe jep mendime për raportet afariste dhe financiare për punën e organizatave me status me interes publik,
 - propozon ngritjen e procedurës për kundërvajtje dhe
 - e përcakton raportin vjetor për punën e saj për vitin paraprak,
- (2) Komisioni miraton rregullore për punën e tij.
- (3) Raportin nga paragrafi (1) alineja 4 Komisioni e shpall në ueb faqen e tij.

9. Punë administrative-teknike

Neni 81

(1) Punët administrativo-teknike të Komisionit i kryen Sekretari i përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

(2) Sekretari i përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë - Njësia organizative për bashkëpunim me organizata qytetare:

- përgatit propozime për dhënien e statusit të organizatës me interes publik pas kërkesës së dorëzuar nga ana e organizatave,
- i jep ndihmë profesionale dhe teknike Komisionit për zbatimin e aktiviteteve të saj,
- i përgatit mbledhjet e Komisionit,
- shqyrton raporte të dorëzuar nga organizatat me status me interes publik dhe përgatit propozim për Komisionin për veprim sipas raporteve,
- përgjigjet në pyetjet e parashtruara nga organizatat me status me interes publik dhe personat e tjerë të interesuar,
- jep informata dhe këshilla për çështjet juridike që kanë të bëjnë me organizatat me status me interesit publik,
- dorëzon aktvendim për dhënien dhe marrjen e statusit me interes publik në Regjistrin Qendror,
- mban bazë elektronike të të dhënave për punën e Komisionit dhe informatë për organizatat e regjistruara me status me interes publik,
- e ndjek punën e organizatave me status me interes publik,
- e shpall listën e shoqatave dhe fondacioneve të cilave ju është dhënë status i organizatës me interes publik për vitin paraprak dhe
- kryen edhe punë të tjera të përcaktuar me këtë ligj dhe me tjetër ligj.

10. Procedurë për marrjen e statusit të organizatës me interes publik

Neni 82

(1) Kërkesa për fitimin e statusit të organizatës me interes publik parashtrohet në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë nëpërmjet Komisionit.

(2) Nëse vërtetohet se kërkesa nuk është complete, Komisioni do ta thërrasë parashtruesin e kërkesës dhe do t'i caktojë afat prej 15 ditë punë të veprojë sipas vërejtjes.

(3) Nëse në afatin nga paragrafi (2) të këtij neni, shoqata ose fondacioni nuk vepron sipas vërejtjes, kërkesa do të llogaritet se nuk është parashtruar.

11. E drejta për ankesë

Neni 83

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë miraton aktvendim në afat prej 30 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.

(2) Kundër aktvendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, mund të ngrihet kontest administrativ.

(3) Gjykata Administrative për ankesën vendos në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të ankesës.

12. Ndryshimet të cilat shënohen në Regjistër

Neni 84

Nëse organizatat e ndryshojnë aktin për themelim, ose statutin me çka do të humbet statusi i shoqatës dhe fondacionit me interes publik, ose ndryshime të tjera të cilat shënohen në regjistër janë të obliguar që ta informojnë Komisionin në afat prej 30 ditësh pas ndryshimit të bërë.

13. Raportet

Neni 85

(1) Organizata me status me interes publik është e obliguar që për punën e saj një herë në vit të parashtrojë raport afarist dhe financiar, të miratuar nga organi i përcaktuar me statut, për punën e saj, në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë për miratim, ndërsa më vonë deri më 31 mars në vitin rrjedhës për vitin paraprak.

(2) Formularin për formën dhe përmbajtjen e raporteve nga paragrafi (1) të këtij neni, i përcakton ministri i Financave.

14. Revizioni

Neni 86

(1) Shoqata ose fondacioni me status me interes publik, buxheti vjetor i të cilit është mbi 20 000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë janë të obliguar që të kryejnë revizion të pavarur vjetor në punën e tyre financiare, ndërsa nëse kanë buxhet mbi 100 000 euro në kundërvlerë me denarë sipas kursit të mesëm të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, janë të obliguar që të bëjnë revizion në pajtim me standardet ndërkombëtare për kontabilitet.

(2) Raporti për revizionin nga paragrafi (1) të këtij neni parashtrohet së bashku me raportin nga neni 77 paragrafi (2) alineja 4 të këtij ligji, më së paku një herë në vit.

15. Publiciteti i raporteve

Neni 87

Raportet nga nenet 85 dhe 86 të këtij ligji janë publike dhe shpallen në ueb faqen e organizatës me status me interes publik deri më 30 prill në vitin rrjedhës për vitin paraprak.

16. Lehtësimet

Neni 88

Organizatata me status me interes publik, përveç lehtësimeve tatimore dhe doganore në nenin 7 paragrafi (2) të këtij ligji kanë lehtësime plotësuese tatimore dhe doganore në pajtim me ligjin.

17. Pushimi i statusit me interes publik

Neni 89

(1) Statusi i organizatës me interes publik pushon:

- me kërkesë të shoqatës ose fondacionit,
- kur ka pushuar që t'i plotësojë kushtet që janë të nevojshme për fitimin e statusit organizatë me interes publik,
- nëse nuk formon këshill mbikëqyrës dhe nuk vepron në pajtim me statutin,
- nëse nuk parashtron raport në afatet e caktuara me këtë ligj,
- nëse nuk parashtron raport për revizion në afatet e caktuara me këtë ligj dhe
- me punën e saj nuk e pasqyron interesin publik për të cilën e ka fituar statusin.

(2) Qeveria miraton aktvendim për shuarjen e statusit të organizatës me interes publik. Organizata njoftohet për vërejtjet lidhur me alinetë 2, 3, 4 dhe 5 nga paragrafi 1 i këtij neni dhe përcaktohet afati prej 30 ditësh për mënjanimin e tyre. Nëse organizata nuk i mënjanon vërejtjet në afatin e shënuar, miratohet aktvendim për shuarje.

(3) Komisioni miraton aktvendim për pushimin e statusit me interes publik.

(4) Kundër aktvendimit nga paragrafi (2) të këtij neni, mund të parashtrohet ankesë në Gjykatën Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit.

(5) Organizatat me interes publik të cilave u ka pushuar statusi i organizatave me interes publik janë të obliguar që në afat prej 30 ditësh të dorëzojnë raport në Komision për periudhën nga raporti i fundit deri në momentin e pushimit të statusit.

XII. AUTORIZIME PUBLIKE

Neni 90

(1) Organizatave mund t'u ngarkohet kryerje e autorizimit publik, me bartjen e kompetencave nga organi i administratës shtetërore, nga organi i komunave, komunave të qytetit të Shkupit dhe qytetit të Shkupit dhe organeve të tjera të cilat kanë autorizime publike, në pajtim me ligjin.

(2) Autorizimi publik nga paragrafi (1) të këtij neni, ngarkohet në bazë të programit të organizatës në mënyrë dhe procedurë për ngarkim të kryerjes së autorizimit publik, pas thirrje publike në mjetet e informimit publik.

(3) Kriteret, mënyra dhe procedura për ngarkimin e kryerjes së autorizimit publik përcaktohet me ligj nga fusha përkatëse.

(4) Organizatave mund t'u merret kryerja e autorizimit publik, për shkak të keqpërdorimit ose moskryerjes së autorizimit të ngarkuar në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar me ligj.

XIII. DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE

Neni 91

Gjobë në shumë prej 200 deri në 300 euro në kundërvlerë me denarë për kundërvajtje do t'i shqiptohet organizatës e cila kryen veprimtari e cila nuk është në pajtim me qëllimet e saj të përcaktuar me statut nga neni 18 dhe 31 të këtij ligji.

Neni 92

Gjobë në shumë prej 200 deri në 300 euro në kundërvlerë me denarë për kundërvajtje do t'i shqiptohet organizatës e cila në qarkullimin juridik nuk e shfrytëzon emrin të cilin në pajtim me nenin 41 të këtij ligji, është regjistruar në Regjistër.

Neni 93

(1) Gjobë në shumë prej 300 deri në 3 000 euro në kundërvlerë me denarë për kundërvajtje do t'i shqiptohet përfaqësuesit, nëse në afat prej tridhjetë ditësh të përcaktuara në nenin 46 të këtij ligji nuk parashtron fletëparaqitje në Regjistër për regjistrimin e ndryshimeve.

(2) Gjobë në shumë prej 200 deri në 300 euro në kundërvlerë me denarë për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni do t'i shqiptohet edhe organizatës.

Neni 94

Gjobë në vlerë prej 200 deri në 300 euro në kundërvlerë me denarë për kundërvajtje do t'i shqiptohet organizatës e cila mjetet e organizatës nuk i shfrytëzon në pajtim me nenin 50 të këtij ligji.

Neni 95

Gjobë në vlerë prej 200 deri në 300 euro në kundërvlerë me denarë për kundërvajtje do t'i shqiptohet organizatës e cila nuk i shpall raportet për punën financiare në pajtim me nenin 53 nga ky ligj.

Neni 96

Gjobë në vlerë prej 200 deri në 300 euro në kundërvlerë me denarë për kundërvajtje do t'i shqiptohet organizatës e cila nuk do ta lajmërojë Komisionin për ndryshimet nga neni 84 të këtij ligji.

Neni 97

(1) Gjobë në shumë prej 300 deri në 3 000 euro në kundërvlerë me denarë, për kundërvajtje do t'i shqiptohet personit përgjegjës në organizatën me status me interes publik, nëse nuk parashtron raport narrativ dhe financiar në pajtim me nenin 85 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 200 deri në 300 euro në kundërvlerë me denarë, për kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni do t'i shqiptohet edhe organizatës.

Neni 98

Gjobë në vlerë prej 200 deri në 300 euro në kundërvlerë me denarë për kundërvajtje do t'i shqiptohet organizatës me status me interes publik, nëse nuk bën revizion vjetor të punës së saj financiare dhe nuk parashtron raport në pajtim me nenin 86 të këtij ligji.

Neni 99

Gjobë në vlerë prej 200 deri në 300 euro në kundërvlerë me denarë për kundërvajtje do t'i shqiptohet organizatës me status me interes publik, nëse nuk i shpall raportet në pajtim me nenin 87 të këtij ligji.

Neni 100

Gjobë në vlerë prej 200 deri në 300 euro në kundërvlerë me denarë për kundërvajtje do t'i shqiptohet organizatës me status me interes publik, nëse në afat prej tridhjetë ditësh nuk dorëzon raport në Komision, në pajtim me nenin 89 paragrafi (4) të këtij ligji.

Neni 101

Para parashtrimit të kërkesës për ngritjen e procedurës për kundërvajtje ndaj kryerësit, për kundërvajtje do t'i ofrohet barazim nga Ministria e Financave si organ kompetent për kontrollin e punës financiare të organizatave.

XIV. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 102

Në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të miratohen aktet nënligjore të përcaktuar me këtë ligj.

Neni 103

Procedurat e filluara për regjistrimin e organizatave të filluara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të përfundojnë sipas dispozitave të këtij ligji.

Neni 104

(1) Organizatat janë të obliguara që në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, t'i harmonizojnë aktet me këtë ligj dhe të kryejnë reregjistrim në Regjistër.

(2) Për organizatat të cilat kanë qenë të regjistruara në Regjistër, reregjistrimin në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të kryhet pa pagesë të taksës ose llojit tjetër të kompensimit.

Neni 105

Prona dhe mjetet e ndara organizatave shoqërore dhe shoqatave të qytetarëve, të marra për shfrytëzim nga ana e bashkësive shoqërore-politike të mëparshme dhe bashkësive vetadministruese të interesit, janë në pronësi të shtetit.

Neni 106

(1) Shoqatat e qytetarëve pasardhës juridikë të organizatave shoqërore dhe shoqatave, do ta shfrytëzojnë pronën në pronësi të shtetit me qira, nëse shfrytëzohet për qëllimet dhe detyrat e shoqatës së qytetarëve në pajtim me ligjin.

(2) Prona nga paragrafi (1) të këtij neni nuk mund të jetë objekt i dhënies me qira nga ana e qiramarrësit-organizatës.

(3) Shoqatat e qytetarëve pasardhës juridikë të organizatave shoqërore dhe shoqatave të formuara për qëllime humanitare, do ta shfrytëzojnë pronën në pronësi të shtetit me qira pa kompensim, nëse ai shfrytëzohet për qëllimet dhe detyrat e shoqatës së qytetarëve.

(4) Raporti i qiramarrjes ndërmjet shoqatës së qytetarëve dhe shtetit, rregullohet me marrëveshje në pajtim me ligjin.

(5) Marrëveshjen për qira në emër të shtetit, e lidh organi i administratës shtetërore i përcaktuar me ligj.

Neni 107

Në afat prej tre muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të formohet Komision nga neni 79 paragrafi (2) të këtij ligj.

Neni 108

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, Regjistri është i obliguar që ta harmonizojë mbajtjen e regjistrave të përcaktuar me nenin 40 paragrafi (1) të këtij ligji.

Neni 109

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji pushon të vlejë Ligji për shoqatat e qytetarëve dhe fondacioneve ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 31/98 dhe 29/2007).

Neni 110

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", përveç dispozitave nga Kapitulli XI. Statusi i organizatave me interes publik, të cilat do të fillojnë të zbatohen gjashtë muaj nga dita e hyrjes së tij në fuqi.